



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 537/12 prot.

Tiranë, më 17.12.2025

V E N D I M

Nr.302, datë 17. 12 .2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.69 Regj., datë 25.03.2025, paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku” kundër Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë/Teatrit të Kukullave, Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, si pasojë e mungesës së aksesueshmërisë në godinën e Tetarit të Kukullave, Tiranë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese/Fondacioni “Së Bashku”, parashtron se, Teatri i Kukullave Tiranë, është rinovuar së fundmi, por gjatë një vizite aty më 21 mars 2025, është konstatuar se nuk ka elementë aksesueshmërie për personat me aftësi të kufizuara dhe konkretisht:

- Ka shkallë në hyrje, brenda në korridore dhe kur hyn në sallën kryesore.
- Në sallë nuk ka hapësira të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.
- Nuk ka tualete të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.
- Nuk ka elemente për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Ky rikonstrukcion është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit “*Për planifikimin e territorit*”.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

Përfundimisht pala ankuese kërkon konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës në përputhje me standardet më të mira të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

II. Nga shqyrtimi i ankesës, u konstatua se:

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.537/1 prot., datë 10.04.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë/Teatri i Kukullave, Tiranë, në lidhje me pretendimet e paraqitura nga pala ankuese.
2. Me shkresën nr.116/1 prot., datë 15.04.2025, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë/Teatri i Kukullave Tiranë, ktheu përgjigje, duke parashtruar ndër të tjera se:

Godina e Teatrit të Kukullave është restauruar në kuadër të programit EU4Culture me fokus “*Rehabilitimin dhe Rijetëzimin e Trashëgimisë Kulturore si pasojë e tërmetit të vitit 2019 në Shqipëri dhe impakti i pandemisë globale Covid-19*”, financuar nga Bashkimi Europian. Pra, projekti është kryer sipas standardeve europiane. Informacioni në lidhje me rikonstruksionin e godinës së Teatrit të Kukullave dhe vlerës së investimeve të realizuara, nuk disponohet nga ana e Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, por gjendet pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, më datë 25.6.2025 zhvilloi seancën dëgjimore. Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë/Teatri i Kukullave Tiranë, shprehen angazhimin dhe gadishmërinë për të rregulluar dhe protësuar të gjitha elementët e aksesueshmërisë, në bashkëpunim me palën ankuese.
4. Nëpërmjet *e-mailit* datë 09.09.2025, pala ankuese informoi Komisionerin se kishte vendosur në dispozicion të Qendrës Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, materialet dhe konstatimet mbi mangësitë në aksesueshmërinë e godinës të Teatrit të Kukullave.

5. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 02.10.2025, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë informoi se, nënkontraktorët e UNOPS kanë montuar mbajtëset e tualetit për personat me aftësi të kufizuara. Për aksesorët dhe shenjuesit e tjerë, projekti ishte mbyllur dhe nuk bëhej shtesë buxheti. Disa rampa shtesë do të bëhen me porosi me buxhetin e vitit 2026. Me fondet në dispozicion Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë e ka të pamundur që të adresojë elementët e aksesueshmërisë që mungojnë.
6. Nëpërmjet shkresave nr.537/3 prot., datë 5.6.2025, nr.537/7 prot., datë 14.8.2025 dhe nr. 537/8 prot, datë 8.10.2025, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit), në lidhje me procesin e rikonstruksionit të Teatrit të Kukullave, Tiranë dhe sigurimin e elementëve të aksesueshmërisë. Nëpërmjet shkresës nr. 537/8 prot., datë 08.10.2025, Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit iu vendosën në dispozicion konstatimet e detajuara mbi mangësitë në aksesueshmërinë e godinës së Teatrit të Kukullave, të paraqitura nga pala ankuese, Fondacioni Së Bashku.
7. Nëpërmjet shkresës nr. 468/1 prot., datë 22.10.2025, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS), informoi Komisionerin se, në lidhje me projektin “*Restaurimi i Teatrit të Kukullave*”, Tiranë, Monument Kulture, Kategori I-rë, nga këndvështrimi i zbatimit të kërkesave për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave kanë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve përkatëse. Aktualisht janë montuar mbajtëset e tualetit për personat me aftësi të kufizuara dhe janë porositur rampat shtesë për pjesën e korridoreve. MTKS, deklaroi se në vijim, në bashkëpunim me UNOPS, do të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës në godinën e Teatrit të Kukullave, duke shtuar sinjalistikën përkatëse dhe elementët e nevojshëm për këtë kategori dhe se mbetet e hapur për bashkëpunim të mëtejshëm, në këtë drejtim, në zbatim të legjislacionit në fuqi.
8. Në vijim, me shkresën nr. 1584/1 prot., datë 21.11.2025, MTKS, informoi se në buxhetin e vitit 2026, i cili pritet të miratohet në Kuvent, referuar edhe udhëzimeve të UNOPS, do të shohë mundësinë për fonde të dedikuara për vendsojen e sinjalistikës përkatëse dhe për përmbushjen e të gjitha nevojave të tjera që lidhen me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në godinën e Teatrit të Kukullave.
9. Sa më sipër dhe bazuar në në nenin 33, pika 9, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar përcaktohet se : “9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.”, Komisioneri me shkresën nr.537/8, datë 8.10.2025, i ka parashtruar Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, mundësinë e parashikuar nga neni 33, pika 9, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Komisioneri konstaton se, gjatë procedurës për shqyrtimin e ankesës, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, kanë filluar marrjen e masave për të adresuar një pjesë të elementëve të munguar të aksesueshmërisë dhe kanë planifikuar masa për të adresuar gjatë vitit 2026, elementët e tjerë të aksesueshmërisë në godinën e Teatrit të Kukullave, Tiranë.

Sa më sipër, bazuar në parashikimin e mësipërm ligjor, si dhe duke mbajtur në konsideratë sjelljen e treguar nga ana e subjekteve Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, nëpërmjet marrjes së masave gjatë procedurës, si dhe planifikimin e masave për të siguruar aksesueshmërinë e plotë me buxhetin e vitit 2026, si dhe duke pranuar se masat e nevojshme për të siguruar aksesueshmërinë e plotë kërkojnë një afat kohor të arsyeshëm për t'u realizuar, për t'iu dhënë mundësinë palëve që në bazë të nenit 33, pika 9, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, të realizojnë zgjidhjen e çështjes me pajtim, Komisioneri vendosi që procedura për shqyrtimin e ankesës nr. 69, datë 25.3.2025, paraqitur nga Fondacioni "Së Bashku", duhet të pezullohen, deri në datë 30.06.2026, me qëllim plotësimin e kërkesave të aksesueshmërisë në godinën e Teatrit të Kukullave, Tiranë, nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32 dhe 33, pika 9, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pezullimin e procedurës administrative, lidhur me shqyrtimin e ankesës nr. 69, datë 25.03.2025, të Fondacionit "Së Bashku" deri në datë 30.06.2026, me qëllim plotësimin e kërkesave të aksesueshmërisë në godinën e Teatrit të Kukullave, Tiranë, nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI

Robert GAJDA